



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:050959

Datë: 04.05.2022

Numri i dokumentit: 02975965

C. nr. 1015/20

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil përmes gjyqtarit Venhar Salihu, në çështjen kontestimore të paditëses A.... B.... nga fsh. M..., K. Gj., të cilën me autorizim e përfaqëson av. M.. S... nga Gj..., kundër të paditurës K... e Gj..., të cilën e përfaqëson me autorizim, jurist nga Gjilani, me objekt kontesti, kompensim të shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit, shpenzimeve të udhëtimit si dhe kompensimin e pagesës diferenciale sipas kualifikimit të licencës, vlera e kontestit 5,687.55€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik të datës 23.03.2022, jashtë seance më dt. 01.04.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A... B.... kundër të paditurës K..e Gj...dhe **DETYROHET** e paditura, që paditëses t'i paguajë në emër të shpërblimit jubilar shumën prej 344.25€, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shumën prej 1418.00€, në emër të shpenzimeve të udhëtimit, të paguaj shumën prej 397.04€, si dhe në emër të kompensimit të pagesës diferenciale sipas kualifikimi të licencës, shumën prej 3,528.26€, përkatësisht shumën përgjithshme në lartësi prej 5,687.55€, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. OBLIGOHET e paditura që paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 270.00€.

A r s y e t i m i

Paditësja më dt. 10.04.2020 në këtë gjykatë ka parashtuar padi kundër të paditurës, me objekt të kontestit, kompensim të shpërblimit jubilar,shpenzimeve të udhëtimit dhe të shpenzimeve të ushqimit, kurse më dt. 28.02.2022, në këtë gjykatë ka dorëzuar parashtresën për ndryshimin objektiv të kërkesëpadisë, ku nga gjykata ka kërkuar që të obligohet e paditura, që paditëses për mbi 20 vite të përvojës së punës, t'i paguajë vlerën prej 75% të një page bazë, pra shumën prej 344.25€, në emër të shpenzimeve të udhëtimit t'i paguaj shumën prej 397.04€, në emër të shpenzimeve të ushqimit për 709 ditë, ku për çdo ditë nga 2.00€, t'i paguajë shumën prej 1,418.00€, kurse në ndryshimin e bërë në seancën gjyqësore ka bërë ndryshimin objektiv të kërkesëpadisë ku në emër të kompensimit të pagesës diferenciale sipas

kualifikimit të licencës t'i paguaj në shumë prej 3528.26€, ku për çdo muaj t'i paguajë shumën prej 78.10€, respektivisht shumën e përgjithshme për të gjitha kërkesat në lartësi prej 5,687.55€ me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Në përgjigjen në padi si dhe në parashtresën e dt. 22.03.2022, e paditura në tërësi e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadiës, duke pretenduar se në lidhje me këtë çështje kompetente nuk është Gjykata Themelore-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil në Gjilan, por është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, se Kontrata Kolektive e lidhur ndërmjet MASHT-it dhe SBASHK-ut, për Komunën e Gjilanit kjo kontratë kolektive, nuk krijon obligime pasi që Komuna e zhvillon aktivitetin e saj në bazë të LVL-së, se kontrata kolektive nuk mund të ketë të drejta më të favorshme për palët që kanë nënshkruar sesa Ligji i Punës, se paditësja punon me orar jo të plotë të punës. Gjithashtu kërkesat e paditëses kanë arritur afatin e parashkrimit, si dhe kërkesa për kompensim të pagesës diferenciale sipas kualifikimit të licencës, është e bazuar në licencën e cila nuk ka validitet pasi që i ka skaduar më dt. 11.09.2017, andaj të drejtat e tilla nuk mund t'i takojnë. Për këto arsye ka kërkuar nga gjykata, që padia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata, në lidhje me këtë çështje më dt. 23.03.2022, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, ku për shkak të pandërlíkueshmërisë së çështjes, e në bazë të nenit 401 të LPK-së, nuk ka konvokuar seancë përgatitore, por ka vazhduar me shqyrtimin kryesor të çështjes.

Kërkesat e Palëve

Paditësja, përkatësisht përfaqësuesi i saj, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 23.03.2022 dhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe ndryshimit objektiv të kërkesëpadiës të bërë përmes parashtresës të dt. 28.02.2022 si dhe në shqyrtimin gjyqësor të dt. 23.03.2022. Ndërsa në shpjegimet përfundimtare ka kërkuar që kërkesëpadija e paditëses të aprovohet si e bazuar, kurse në lidhje me shpenzimet e procedurës ka kërkuar shumën prej 270.00€, në të cilat përfshihen: për taksë gjyqësore shumën prej 31.00€, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00€ dhe për përfaqësim në një seancë shumën prej 135.00€.

Përfaqësuesi i të paditurës, si në shqyrtimin kryesor të dt. 23.03.2022 dhe në shpjegimet përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë përgjigjes në padi si dhe parashtresës së dt. 22.03.2022, duke kërkuar që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet si e pabazuar, kurse sa i përket shpenzimeve të procedurës, ka kërkuar nga gjykata që të veprojë në bazë të nenit 453.1 të LPK-së.

Gjendja faktike

Gjykata, në shqyrtimin gjyqësor të dt. 23.03.2022, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse ka vërtetuar se për palët ndërgjyqëse nuk janë kontestuese këto fakte se: Paditësja është në marrëdhënie të punës tek e paditura, përkatësisht në SH.M.T. "M... I...." në Gjilan, kurse jeton në fsh.Malishevë, K. Gjilan dhe për të udhëtuar në vendin e punës bileta e saj në dy drejtimet kushton 0.80€. Paditësja ka mbi 20 vite të përvojës së punës, kurse paga bazë e paditëses është 459.00€, për palët ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestuese edhe faktet se paditësja nga viti 2017 deri në vitin 2021, ka realizuar gjithsej 709 ditë të punës, si dhe fakti se në shkollën

ku punon paditësja, nuk ka shërbime të kuzhinës, gjithashtu nuk kanë të angazhuar ndonjë lloj furnizimi të ushqimeve në këtë shkollë. Po ashtu nuk është kontestuese shuma prej 3,528.26€ në emër të kualifikimit si dhe shumat e tjera të kërkuara sipas kërkespadiës, por kontestuese në mes palëve ka qenë baza juridike e kërkesave.

Për shkak që faktet e lartcekura nuk kanë qenë kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse, gjykata nuk ka administruar provat materiale për vërtetimin e fakteve të paraqitura në padi.

Vendimi i gjykatës

Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017 dhe e dt. 22.01.2021, sa i përket kërkesëpadiës për shpërblimin jubilar, gjykata gjeti se kërkesa për këtë kategori është e bazuar, edhe atë në nenin 35.8, nën-paragrafi 8.2, ku nuk ka qenë kontestuese se paditësja ka mbi 20 vite të përvojës së punës, dhe për këtë arsye ka të drejtë të kompensohet në vlerë të 75% të një page bazë, pra në shumë prej 344.25€ nga e paditura (pasi që nuk ka qenë kontestuese se paga bazë është shuma prej 459.00€ dhe vitet e përvojës së punës) dhe për këto arsye, duke zbatuar nenin e lartcekur lidhur me nenin 35.8, nën-paragrafi 8.5 gjykata vendosi që ta aprovojë kërkesëpadinë sa i përket shpërblimit jubilar në shumë prej 344.25€.

Gjykata duke u bazuar në nenin 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017 dhe asaj të dt. 22.01.2021, ka aprovuar si të bazuar kërkesën e paditësës në lidhje me shpërblimin e ushqimisë, andaj e paditura, obligohet që për 709 ditë të punës së paditësës nga dt. 18.04.2017 deri 18.04.2021 për çdo ditë t'ia kompensojë nga 2€, e që në total i bie shuma prej 1,418.00€ në emër të ushqimisë, për faktin se nuk ka qenë kontestuese se aty ku punon paditësja nuk ka të organizuar kuzhinë, ditët dhe shuma e kërkuar, kurse dispozita e lartëcekur ligjore ka paraparë një të drejtë të tillë, dhe për këtë arsye u aprovua si e bazuar kërkesëpadija sa i përket ushqimisë.

Gjykata ka vërtetuar se duke u bazuar në nenin 35, paragrafi 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017 dhe asaj të dt. 22.01.2021, kërkesa e paditësës në lidhje me kompensimin për shpenzimeve të udhëtimit, ka bazë juridike, andaj Komuna e Gjilanit, obligohet që për 709 ditë të punës së paditësës që ka realizuar nga dt. 18.04.2017-18.04.2021, për çdo ditë t'ia kompensojë vlerën prej 70% të biletave të trafikut publik në shumë prej 2.00€, ku shuma e përgjithshme është 397.04€. Kjo llogaritje është bërë me anë të matematikës së thjeshtë ($709 \times 0.80€ \times 70\% = 397.04€$).

Gjykata vërteton se duke u bazuar në nenin 7.1, nën-paragrafi 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të dt. 18.04.2017, kërkesa e paditësës në lidhje me kompensimin e pagesës diferenciale sipas kualifikimit të licencës master, ka bazë juridike, andaj e paditura, obligohet, t'i paguajë 35% të një page bazë, përkatësisht shumën prej 78.10€ për muaj në emër të kualifikimit (diplomë universitare e nivelit master), pra t'i paguhet shuma totale prej 3,528.26€, edhe përkundër se shuma e kërkuar nuk ka qenë kontestues.

Sa i përket kamatës gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382.2 të LMD-së.

Prandaj, për këto arsye vendosi si në pikën I të diapozitivit të këtij aktgjykim

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, që ta detyrojë të paditurën si palë humbëse në këtë proces gjyqësor që paditësës t'ia paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore në vlerë prej 270.00€, ku në emër

të taksës gjyqësore shumë prej 31€, në emër të përpilimit të padisë, shumë prej 104€, si dhe në emër të përfaqësimit në një seancë gjyqësore shumë prej 135€.

Për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Kontratën Kolektive, ku në nenin 2 të kësaj kontrate është paraparë se dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjitha punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e Institucioneve të Arsimit të Lartë, MASHT-in etj.) pra në tërë territorin e RKS-së, duke përfshirë edhe institucionet publike, por edhe ato private. Gjithashtu, në nenin 5 të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës me nr. 03/L-068, janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës sa i përket shpërblimit jubilar, gjykata një pretendim të tillë e konsideron të pa bazë, me arsyetimin se paditësja ka arritur një përvojë të punës prej mbi 20 viteve dhe se ende vazhdon të realizojë aktivitetin punues në kuadër të SH.M.T “M.... I....”. Andaj duke pasur parasysh se Kontrata Kolektive e Arsimit ka hyrë në fuqi më dt. 18.04.2017, kurse paditësja padinë e ka paraqitur më dt. 10.04.2020, pra brenda afatit kohorë të paraparë me ligj, përkatësisht në nenin 87 të Ligjit të Punës i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga mardhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”, pra nga kjo shohim se nuk kan kaluar tri vite nga momenti i hyrjes në fuqi, e deri në paraqitjen e padisë.

Gjykata, gjithashtu e konsideron të pabazë pretendimin e të paditurës në lidhje me atë se paditësja punon me orar jo të plotë të punës, andaj nuk i takojnë këto të drejta. Ky pretendim është i pabazë, ngase bazuar në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 21, paragrafi 3, ku shprehimisht thuhet se i punësuarit me orar jo të plotë gëzon të drejta dhe detyrime të njëjta me të punësuarin me orar të plotë.

Për gjykatën, është i pabazuar pretendimi i të paditurës se në rastin konkret, paditëses nuk i takon kompensimi sa i përket pagesës diferenciale sipas kualifikimit të licencës për shkak të skadimit të licencës. Gjykata, vlerëson se çështja se licenca është e afatizuar apo jo, duhet të zgjidhet në procedurë administrative, në bashkëveprim me MASHT-in dhe DKA-në, ku në U.A. 05/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë është e paraparë decidivisht procedura që duhet ndjekur, në situatën kur mësimdhënësit i skadon validiteti i licencës.

Prandaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C. nr. 1015/20, dt. 01.04.2022

Gjyqtari,
Venhar Salihu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.